

Tani

Klima nuk mund të pres.

Është tani kur ne zgjedhim rrugë

Tani akulli në Arktis po shkrihet. Tani luftërat dhe konfliktet po rritenë gjurmët e thatësisë. Ndryshimet klimatike nuk janë më çështje të së ardhmes. Ato po ndodhin tani.

Gjatë kohës së Partisë Ekologjike në qeveri buxheti i Suedisë për mjedis është më tepër se dyfishuar. Partitë e tjera duan akoma t'a ndalin dhe të bëjnë shkurtime në politiken e domosdoshme për klimë. Kur vendimet duhet të merren – atëherë ekziston vetëm një parti ekologjike.

Zgjidhjet janë: 100% energji e ripërtritshme, trena të shpejtë, ushqim bio, zona rurale

që gjallërojnë dhe qytete miqësore për fëmijë. Një shoqëri ku ne nuk e konsumojmë as planetin e as vetveten.

Zgjedhjet 2018 bëjnë fjalë që ne të mund t'i shikojmë fëmijët dhe nipat/mbesat tona në sy dhe t'u themi se ne kemi bërë gjithçka që kemi mundur.

Klima nuk mund të pres.

Sa shumë bëjnë kaq shumë. Për mjedisin për njëri-tjetrin. Por që Suedia të mund të bëhet vendi i parë i mirëqenies pa fosile atëherë kërkohet të dimë se çfarë duhet të bëjmë bashkarisht.

Hy në mp.se dhe lexo më shumë se çfarë duam ne dhe cilën diferencë mund t' a bëjë vota e juaj.

Voto për Partinë Ekologjike më 9 shtator!



Partia Ekologjike do

Investime në trena të shpejtësisë së madhe, zgjerimin dhe shtimin e pajisjeve në hekurudhë në tërë vendin.

Duhet të jetë e thjeshtë të udhëtohet në favor të klimës me trena që qarkullojnë me kohë dhe një sistem të koordinuar biletash. Ne duam të fillojmë me trena të natës për në kontinent dhe të zgjerojmë rrjetin e rrugëve për bicikleta, trafikun kolektiv dhe lëndët e përtërishme të djegies në tërë Suedinë.

Përkrahe ushqimin bio dhe atë që është në favor të klimës.

Shkollat dhe shtëpitë e pleqëve duhet të shërbejnë më shumë ushqim bio e të prodhuar në afërsi. Ne duam të vëjmë një taks për mish të importuar ku sasi të panevojshme të antibiotikëve janë përdorur gjatë rritjes së kafshëve.

Ndalo përhapjen e plastikës dhe helmeve në det dhe ujë.

Ne duam të mbrojmë edhe më shumë zona detare, të ndalojmë artikuj të panevojshëm plastik dhe të vëmë një taks për artikuj që përdoren vetëm një herë. Bizneset duhet të deklarojnë kohëzgjatjen e produkteve dhe duhet të jetë më i lehtë reparimi i tyre.

Partia ekologjike të gjelbërtit Nëse do të n'a japësh nmjë kontribut financiar, dërgo swish 123 453 50 50.

Anëtarësohu në www.mp.se/bli-medlem

Tu jepet më shumë mundësi për të vendosur mbi kohën dhe jetën profesionale.

Ne duam të zvogëlojmë orarin e punës dhe të investojmë në paga dhe pensione të barabarta. Punësimet e reja ekologjike do të shtohen kur ne të investojmë në teknik të mençur ekologjike dhe në të mësuarit gjatë tërë jetës.

Të rinjët që ndjehen keq t'u jepet ndihmë me kohë.

Ne duam të forcojmë shëndetësinë e nxënësve dhe gradualisht të realizojmë që të mos ketë radhë pritje për në psikiatrinë për fëmijë dhe rini. Nxënësve do u jepet më shumë kohë me mësimdhënësit e tyre ndërsa mësimdhënësve ndihmë në punë e tyre. Do të realizohet garancia e leximit-shkrimit dhe numërimit.

Suedia të qëndroj prapa paqes, barazisë dhe një politike humane për refugjatë.

Suedia nuk duhet të eksportoj armë në vendet me diktaturë dhe ne i themi Jo, anëtarësimin në Nato. Ne duam ta mbrojmë të drejtën e azilit dhe refugjatëve tu japim të drejtë që të bashkohen me familjet e tyre. Kjo ka të bëjë me humanitetin bashkënjëzëror.